



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 74, datë 30.03.2022

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË “ALBSIG INVEST-SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE” SH.A., SI REZULTAT I RRIJTJES SË KAPITALIT.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, të Rregullores nr. 112 datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e ndryshimit të nenit 5, pika 1, të statutit të shoqërisë “Albsig Invest-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” sh.a., si rezultat i rritjes së kapitalit si më poshtë:**

“5.1 Kapitali i nënshkruar dhe tërësisht i paguar i shoqërisë është 69,000,000 (gjashtëdhjetë e nëntë milion) lekë, i cili përbëhet nga 69,000 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë) aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 1,000 (një mijë) lekë secili. Kapitali është nënshkruar dhe paguar si më poshtë:

5.1.1 Shoqëria “Albsig Jetë” sh.a., zotëron 69,000 (gjashtëdhjetë e nëntë mijë) aksione të cilat përbëjnë 100 % (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë”.

- 2. Ngarkohet Drejtorja e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE